



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINES
MUNICIPALITY OF KLINA
OPSTINA KLINA



www.komuna-klina.org

24.07.2020

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Thirrje publike!

10 951-17216/20

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve, qe veprojnë ne Komunën e Klinës, respektivisht Shoqatat e dalura të luftës.

I. Komuna e Klinës –Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, duke u bazuar në: rregullore MF - nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, u bënë thirrje Organizatave Jo-Qeveritare te Shoqatave te dalura të luftës **qe veprojnë ne Komunën e Klinës,** të aplikojnë për mbështetje financiare për vitin 2020.

1. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:

Në fushën e tyre përkatëse:


- Organizimi i aktiviteteve të Shoqatave të dalura nga lufta e UÇK-së
- Sipas fushëveprimtarisë së tyre qe i kanë në status

2. Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision profesional 5-anëtarësh, të cilët do ti vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Vlerësimi do të bëhet sipas:

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit;
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes;
3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues;
4. Vazhdimësisë së realizimit të programit dhe qëndrueshmërisë së tij;
3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:

- Formulari i aplikimit- Aplikacioni për projekt për OJQ- të ose Projekt propozim me kërkesë për subvencion
- Dokumenti identifikues;
- Çertifikata e regjistrimit OJQ; Nr.fiskal, te jetë nën dega në Klinë;
- Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.
- 4. Formulari për aplikim mund të merret në web-faqe të Komunës apo në zyrat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mund të dorëzohen duke filluar nga data **24.07.2020 deri më 31.07. 2020.** Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



Aplikimet

1. OJQ-të, në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt, për secilën nga fushat e thirrjes.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare të regjistruara në Ministrinë përkatëse dhe të cilat veprojnë në Komunën e Klinës.
3. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët apo projekt propozimin për perkrahje e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Klinës dhe në DKRS
4. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në adresën e mëposhtme:
Komuna e Klinës
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ndërtesa e kuvendit Komunal Klinë
5. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Vërejtje: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet e sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për Shqyrtimin e kërkesave.

Klinë, 24.07.2020

Drejtori
Skender MERTURI

